



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2512, datë 06.11.2014

Për

“Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj Alketa	Mukavelati	Anëtare
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 06.11.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimi në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS””

BAZA LIGJORE:

1. Shkronja g) dhe gj) e nenit 8, pika 2 e nenit 65, neni 66 dhe pika 1) dhe 2) e nenit 68, të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “ Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*), i ndryshuar;
2. Kodi i Procedurës Administrative (*KprA*);
3. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”.

4. Urdhëri Nr. 1272 datë 19.08.2014 për “Ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave për aplikimet TRA-ECS në brezin 2500 – 2690 MHz””

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

1. Relacioni shpjegues mbi dokumentin për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimi në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS”;
2. Dokumenti për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimi në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS”;
3. Projektvendimi përkatës, si dhe diskutimet në mbledhje mbi çështjen;

Duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N s e :

1. Dokumenti për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimi në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS” është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor përkatës.
2. Hartimi i dokumentit është bazuar në pikën 2 të nenit 65, pikën 1 dhe 2) të nenit 68 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918), i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”
3. Qëllimi rregullator mbi dhënien në përdorim të këtyre frekuencave është:
 - të rrisë efektivitetin e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave
 - tu japë mundësi operatorëve të interesuar për përdorimin e këtij spektri për shtimin e kapaciteteve ekzistuese
 - të krijojë një kuptim më të qartë për impaktin që do të ketë dhënia në përdorim e këtyre brezave ;
 - të njohë interesin për marrjen në përdorim të tyre (numrin e kërkesave) ;
 - të njohë çmimin që janë të gatshëm të ofrojnë të interesuarit për një brez të caktuar ;
 - si dhe të mundësojë krijimin e një terreni të përshtatshëm për procedurën e dhënies së të drejtave të përdorimit të frekuencave, etj.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

1. Bazuar në Kodin e Procedurave Administrative, dhe ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar dhe ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “ Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*), i ndryshuar;

V E N D O S:

1. Miratimin e dokumentit për këshillim publik “Mbi dhënien e të drejtave të përdorimi në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS” sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Periudha e këshillimit publik fillon nga data e publikimit të dokumentit në mediat e shkruara kombëtare dhe është 30 ditë.
3. Njoftimi për këtë këshillim të botohet në gazeta të përditshme në vend.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE

NJOFTIM PËR KËSHILLIM PUBLIK

MBI

DHËNIEN NË PËRDORIM TË BREZAVE TË FREKUENCAVE

TRA-ECS

2500-2690 MHz

1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - AKEP,

a) Bazuar në:

- Germen g) dhe gj) e nenit 8, pika 2 e nenit 65, neni 66 dhe pika 1) dhe 2) e nenit 68 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918), i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”,

b) Me qëllim:

- të rrisë efektivitetin e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave
- të japë mundësi operatoreve të interesuar për përdorimin e këtij spektri për shtimin e kapaciteteve ekzistuese
- të krijojë një kuptim më të qartë për impaktin që do të ketë dhënia në përdorim e këtyre brezave ;
- të njohë interesin për marrjen në përdorim të tyre (numrin e kërkesave) ;
- të njohë cmimin që janë të gatshëm të ofrojnë të interesuarit për një brez të caktuar ;
- si dhe të mundësojë krijimin e një terreni të përshtatshëm për procedurën e dhënies së të drejtave të përdorimit të frekuencave, etj.

nis këshillimin publik për dhënie të drejtash përdorimi në brezat e frekuencave 2500-2690 MHz për aplikimet TRA-ECS.

AKEP mendon se interesi në këte brez frekuencash është më i madh se disponibiliteti për caktim në këtë brez.

2. Synimi i AKEP është:

Zbatimi i një procesi dhënie të drejtash përdorimi sa me objektiv dhe transparent në përfitim të konsumatoreve shqiptare dhe ekonomise shqiptare,

krijimin e një tregu konkurrues në Shqipëri, si dhe përdorimin efektiv të spektrit.

3. Burimet e spektrit:

Plani Kombëtar i Radio Frekuencave përcakton brezat 2500-2690 MHz ku mund të autorizohen aplikimet TRA-ECS.

Të drejtat e përdorimit janë parashikuar të jepen në brezin e frekuencave 2500-2690 MHz.

4. Kushtet e përdorimit:

Në Planin Kombëtar të Frekuencave (dhe brenda CEPT) ky brez ky brez është përcaktuar si përdorim kryesor për TRA-ECS. IMT është konsideruar si pjesë e TRA-ECS. Përdorimi i këtij brezi do të bëhet në përputhje me vendimin e "Electronic Communications Committee"- ECC/DEC/(02)06 dhe ECC/DEC/(05)05, me Vendimin e Komisionit të 13 Qershorit 2008 "On the harmonisation of the 2500-2690 MHz frequency band for terrestrial systems capable of providing electronic communications services in the Community" me Rekomandimin e Komitetit ECC/REC (11)05 "Frequency planning and frequency coordination for terrestrial systems for mobile/fixed communication networks (MFCN) capable of providing Electronic Communications Services in the frequency band 2500-2690 MHz, rekomandimin ERC/REC (01)01, standartin EN 301 908 dhe EN 302 544.

5. Bazuar ne dokumentat e mesiperme, raporte te CEPT dhe eksperiencat e vendeve te tjera ne administrimin e ketij brezi, 2500-2690 MHz, AKEP propozon qe:

a) Brezat 2500 – 2570 MHz i ciftuar me 2620 – 2690 MHz do te alokohen per menyren e operimit FDD ku brezi me i ulet duhet te jete i alokuar per transmetuesin e levizshem brenda brezit me te ulet te frekuencave dhe transmetuesi baze brenda brezit te siperm ku blloqet e alokuara te frekuencave do te jene shumefisha te 5 MHz.

b) Brezi 2570 – 2620 MHz do te alokohet ose per menyren e operimit TDD ose FDD ku blloqet e alokuara te frekuencave do te jene shumefisha te 5MHz.

Pyetja 1: A jeni dakort me këtë ndarje të propozuar nga AKEP?

6. AKEP mendon qe sasia e spektrit per te drejte perdorimi te jete 2x5 MHz per brezin e ciftuar dhe 5 MHz per brezin e paciftuar. Ky propozim behet per mundesine teknike te shfrytezimit dhe per te krijuar mundesine qe cdo i

interesuar per perdorimin e ketij spektri te jete pjese e gares pamvaresisht nga kapacitetet e tij. Dmth do te jene 14 te drejta 2x5 MHz ne spektrin e ciftuar dhe dhe 10 te drejta 5 MHz ne spektrin e paciftuar.

Pyetja 2: A jeni dakort me këtë propozim te AKEP?

7. *AKEP per te marre nje vlere reale nga dhenia ne perdorim e ketij spektri mendon qe cmimi te permbaje dy elemente, ate te vleres se perafert dhe ate lineare bazuar edhe ne ekasperiencon e deritanishme. Keshtu nje fitues i te drejtave te perdorimit do te kete mundesine te marre ne perdorim spekter sipas kostos individuale dhe asaj kolektive. Spektri qe mendohet te jepet ne perdorim ne raundin e pare te vleresimit do te kete koston kolektive, pasi dhe sasia e spektrit qe mund ti alokohet nje fituesi do te jete e kufizuar. Spektri qe do te mbetet i pa alokuar ne raundin e pare do te jepet ne raundet tjera te vleresimit dhe kjo ben qe vlere e marre ne keto raunde te jete lineare.*

Pyetja 3: A jeni dakort me këtë propozim te AKEP?

8. *AKEP mendon se sasia e spektrit qe do te kene te drejte te marrin ne raundin e pare te vleresimit fituesit te jete e kufizuar dhe jo me shume se 2x10 MHz (dy te drejta perdorimi 2x5 MHz). Po keshtu ne raundin e dyte te vleresimit jo me shume se 2x10 MHz. Ne raundin e trete te vleresimit sasia maksimale e spektrit qe mund te marrin ofertuesit ne perdorim te jete 2x20 MHz e me tej deri ne dhenien ne perdorim te gjithe spektrit. Te gjithe raundet e vleresimit do te jene brenda te njejtës procedure tenderi.*

Pyetja 4: A jeni dakort me këtë propozim te AKEP?

NDARJA NE BLOQE NE BREZIN 2500-2690 MHZ

Bllloqet FDD Uplink

TDD ose FDD

Bloqet FDD Downlink

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	1'	2'	3'	4'	5'	6'	7'	8'	9'	10'	11'	12'	13'	14'
2500	2505	2510	2515	2520	2525	2530	2535	2540	2545	2550	2555	2560	2565	2570	2575	2580	2585	2590	2595	2600	2605	2610	2615	2620	2625	2630	2635	2640	2645	2650	2655	2660	2665	2670	2675	2680	2685

 Spektri i çiftuar blloqet 1-14 FDD Uplink me blloqet 1'-14' FDD downlink

 Spektri i paciftuar blloqet 1-10 TDD ose FDD

- Pyetja 5: Bazuar ne këtë ndarje cila është vlera që jeni gati të paguani për të drejtë përdorimi 2x5 MHz? Komentet përkatëse.*
- Pyetja 6: Cili është raporti që duhet të ketë në vlerë ky brez krahasuar me brezat 900 MHz, 1800 MHz dhe 2100 MHz?*
- Pyetja 7: Kur mendoni se është koha me e pershtatshme që AKEP të hapë procedurën e dhënies në përdorim të këtij brezi?*
- Pyetja 8: A mund të perputhen në kohe dhënia në përdorim e brezave të lire 1800 MHz me dhënien në përdorim të brezave në 2.6 GHz?*
- Pyetja 8: Në se do të rezultoni fitues i një të drejtë përdorimi cili do të jetë qëllimi i përdorimit të tij? Komentet përkatëse?*
- Pyetja 9: Në se do të rezultoni fitues i një të drejtë përdorimi, cila është teknologjia që do të aplikoni për ndërtimin e rrejtit të aksesit? Komentet përkatëse.*
- Pyetja 10: Kur mendoni se do ishte koha me e pershtatshme për heqjen e kufizimeve teknologjike për brezat në përdorim nga sipërmarrësit duke përfshirë GSM dhe UMTS?*
- Pyetja 11. A mendoni se heqja e kufizimeve teknologjike duhet bërë në të njëjtën kohë me rishpërndarjen e spektrit në përdorim nga sipërmarrësit me qëllim rritjen e efektivitetit të shfrytëzimit apo në ndonjë kohë tjetër?*

9. Procedura e dhënies së Autorizimit

Për këtë çështje AKEP do të mbështetet në nenin 7, nenet 67, 68, 69 e në vazhdim të ligjit Nr. 9918 dt.19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave” dhe VKM nr. Nr.1252 datë 10.9.2008, i ndryshuar, dhe në rezultatet e këtij këshillimi publik.

Pyetja 12: A jeni dakort me këtë propozim?

10. Kriteret e përzgjedhjes

Aplikimi i procedurës së tenderit publik të përcaktuar në Vendimin Nr.1252, datë 10.9.2008 “Për miratimin e rregullave të zhvillimit të tenderit publik, për dhënien e së drejtës së përdorimit të frekuencave”, i ndryshuar.

Pyetja 13: A jeni dakort me këtë propozim?

12. Kriteret e vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit të ofertave të jenë të njëjta me ato të aplikuara në tenderat e meparshe me të zhvilluar për këtë qëllim:

- Çmimi i ofertës

Pyetja 14: A jeni dakort me këtë propozim?

13. Kushti i mbulimit

AKEP fton sipërmarrësit të shprehen në lidhje me kriteret e mbulimit me shërbim në shkallë gjeografike.

14. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së Autorizimit

AKEP mendon që vlefshmëria e autorizimit të lëshuar të jetë 15 vjet.

Pyetja 15: A jeni dakort me këtë propozim?

Argumentat në se keni ndonjë çështje tjetër për tu marrë në konsideratë.